

/e nderuar/a z/znj

FOL'08 përshëndet vendimin e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRrE) që nuk e ka mbështetur në hapin e parë të kërkesës së KEK-ut, për ngritje 18.3 për qind të tarifës së energjisë elektrike po ka sugjeruar që të jetë 2.5 për qind.

Megjithëse ZRRrE ka bërë një hap të mirë me vendimin paraprak, ky institucion nuk iu është përgjigjur pozitivisht kërkesës së 10529 qytetarëve për mos ngritje të tarifës së energjisë elektrike. ZRRrE së bashku me institucionet e tjera të Kosovës duhet të respektojë vullnetin e qytetarëve dhe nuk duhet që zgjidhjen e parë të problemeve financiare për ndonjë institucion ta shohin rritjen e taksës për qytetarin.

Na shqetëson fakti se ngritja e tarifës së energjisë elektrike po promovohet si zgjidhja për problemet e KEK-ut, sidomos për furnizim me energji elektrike. Problemet e KEK-ut do të zgjidhen atëherë kur kjo ndërmarrje do të gëzojë mbështetje të plotë dhe të fuqishme nga të gjitha institucionet dhe nuk do të politizohet. KEK-u duhet të mbështet që të siguroj inkasim të plotë të faturave dhe faturim të plotë të energjisë elektrike.

KEK-u faturon vetëm 50 për qind të energjisë që prodhon dhe nga kjo vetëm 75 për qind inkasohen. KEK-u pëson humbje të mëdha të energjisë elektrike nga rrejtja e dobësuar dhe nga vjedhjet e energjisë elektrike. KEK-u kërkuar që niveli i lejuar i humbjeve komerciale të rritet në 22.7 për qind krahasuar me nivelin e lejuar prej 20 për qind në vitin 2008. Përderisa humbje teknike për vitin 2009 ZRRrE ka aprovuar të jetë në nivelin 17.1 për qind. Edhe pse humbjet nga rrjeti elektrike janë shumë të mëdha KOSTT nga 6.5 milion euro që iu janë aprovuar për shpenzime të mirëmbajtjes ka shpenzuar vetëm 2.7 milion për vitin 2008 përderisa për vitin 2009 ka kërkuar ka kërkuar 5.1 milion euro për mirëmbajtje. KEK-u për vitin 2009 ka pranuar 42.5 milion euro për blerje të energjisë elektrike nga gjithsej 90 milion euro që ka pranuar nga Buxheti i Kosovës, këto janë para të takspaguesve.

Nuk është e drejtë që për shkak të pa-aftësisë së KEK-ut për të siguruar inkasim të faturave dhe faturim të energjisë elektrike qytetarët e përgjegjshëm të cilët paguajnë rrymën të ngarkohen. Ngritja e tarifës së energjisë elektrike vetëm do të vendos një precedent të rrezikshëm jo vetëm për KEK-un por për të gjitha institucionet që sa herë që këto nuk kanë

menaxhim efikas por kanë nevojë për para, qytetarit ti shtohen shuma e taksës. KEK-u edhe vitin e kaluar ka kërkuar ngritje të tarifës dhe një gjë e tillë është realizuar, vitin e kaluar ka pasur rritje për 5 për qind.

Vlerësojmë se ZRrE duhet të dërgoj një porosi të qartë që pa shterje të të gjitha opsioneve ngarkimi financiar i qytetareve është vendimi i fundit ekstrem. Qëllimi qenësor i secilit institucion publik është dhe duhet të jetë mbrojtja e qytetarit dhe interesit publik. ZRrE ka një petition të nënshkruar nga 10529 qytetar, të cilët gjithashtu janë 10529 konsumator të KEK-ut. Është obligim demokratik, ligjor (Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit) dhe Kushtetues që të respektohen këta kërkesat e qytetareve.

Kërkojmë nga ZRrE që përfundimisht të mos i ngrisë tarifat e energjisë elektrike dhe kështu të përmbush një obligim ndaj qytetarëve.

Sinqerisht i juaji,

--

Ramadan Ilazi |
Koordinator |
+377 (0) 44-324-377 | www.fol-08.org